



REPUBLIKA E KOSOVËS
KUVENDI I KOMUNËS-SHTIME
Nr.01-70/05-15347 datë: 21.05.2018



Npi – 01/118 datë: 31.05.2018

Duke u bazuar në nenin 12 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040; Nenit 8 të Rregullores Komunale për Transparencën 01Nr.06/361/4, të datës 4.3.2009; Ligji për menaxhimin e financave publike dhe përgjegjësitë, Nr.03-L-048; Kuvendi Komunës së Shtimes, në mbledhjen e mbajtur më: 31.05.2018 aprovoi këtë:

V E N D I M

PËR DISKUTIM PUBLIK
DRAFT KORNIZËN AFATMESME BUXHETORE TË KOMUNËS SË SHITES
2019-2021

I

Kuvendi i Komunës së Shtimes në mbledhjen e pestë të rregullt për vitin 2018, të mbajtur më 31.05.2018, unanimitisht aprovoi Vendimin për ta nxjerrë në diskutim publik, Draft Kornizën afatmesme buxhetore të Komunës së Shtimes për periudhën 2019-2021, për afatin prej 15 ditësh. Bartës të organizimit të aktiviteteve për procesin e diskutimit publik është Zyra për Financa, Komiteti për Politikë e Financa, dhe Zyra për Informim.

II

Vendimi është aprovuar duke pas parasysh edhe Rekomandimin nga Komitetit për Politikë e Financa.

III

Vendimi u dërgohet: Arkivit, Zyrës për Financa, Drejtorisë për Administratë, Kryetarit të Komunës, Zyrës për Informim dhe Ministrisë për Administrimin e Pushtetit Lokal.



Kryesuesja e Kuvendit
Medina Braha



REPUBLIKA E KOSOVËS
KUVENDI I KOMUNËS-SHTIME
Nr.01-70/05-15347 datë: 21.05.2018



Npi – 01/119 datë: 31.05.2018

Duke u bazuar në nenin 12 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040; Nenit 8 të Rregullores Komunale për Transparencën 01Nr.06/361/4, të datës 4.3.2009; Si dhe duke u bazuar në nenin 7 të Ligjit për Policinë e Kosovës Nr.04/L-076, dhe nenit 6, pika 1.1 të Udhëzimit Administrativ të MPB Nr.27/2012 dhe MAPL Nr.03/2012 për Këshillat Komunale për Siguri në Bashkësi, Kuvendi Komunës së Shtimes, në mbledhjen e mbajtur më: 31.05.2018 aprovoi këtë:

V E N D I M

**PËR DISKUTIM PUBLIK
TË PROPOZIM-PLANIT VJETOR TË PUNËS DHE ZHVILLIMIT TË
PROJEKTEVE PËR RRYTJEN DHE PËRMIRËSIMIN E SIGURISË NË
BASHKËSI 2018-2019**

I

Kuvendi i Komunës së Shtimes në mbledhjen e pestë të rregullt për vitin 2018, të mbajtur më 31.05.2018, unanimisht aprovoi Vendimin për ta nxjerrë në diskutim publik, Propozim-Planin vjetor i punës dhe zhvillimit të projekteve për rritjen dhe përmirësimin e sigurisë në bashkësi 2018-2019, për afatin prej 15 ditësh. Bartës të organizimit të aktiviteteve për procesin e diskutimit publik është Zyra e Kryetarit dhe Zyra për Informim.

II

Vendimi është aprovuar duke pas parasysh edhe Rekomandimin nga Komitetit për Politikë e Financa.

III

Vendimi u dërgohet: Arkivit, Zyrës së Kryetarit, Drejtorisë për Administratë, Kryetarit të Komunës, Zyrës për Informim dhe Ministrisë për Administrimin e Pushtetit Lokal.



Kryesuesja e Kuvendit
Medina Braha



REPUBLIKA E KOSOVËS
KUVENDI I KOMUNËS-SHTIME
Nr.01-70/05-15347 datë:21.05.2018



Npi – 01/120 datë: 31.05.2018

Duke u bazuar në nenin 12 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040; Nenit 8 të Rregullores Komunale për Transparencën 01Nr.06/361/4, të datës 4.3.2009; Si dhe duke u bazuar në Strategjinë e Qeverisë së Republikës së Kosovës për përfshirjen e komuniteteve Rom dhe Ashkali në shoqërinë Kosovare 2017-2021, Kuvendi Komunës së Shtimes, në mbledhjen e mbajtur më: 31.05.2018 aprovoi këtë:

V E N D I M

**PËR DISKUTIM PUBLIK
TË DRAFT-PLANIT LOKAL TË VEPRIMIT PËR PËRFSHIRJEN E
KOMUNITETEVE ROM DHE ASHKALI NË KOMUNËN E SHTIMES 2018-2021**

I

Kuvendi i Komunës së Shtimes në mbledhjen e pestë të rregullt për vitin 2018, të mbajtur më 31.05.2018, me shumicën e votave vendosi për ta nxjerrë në diskutim publik, Draft-Planin lokal të veprimit për përfshirjen e komuniteteve Rom dhe Ashkali në Komunën e Shtimes 2018-2021, për afatin prej 15 ditësh. Bartës të organizimit të aktiviteteve për procesin e diskutimit publik është Zyra për Komunitete dhe Kthim dhe Zyra për Informim.

II

Vendimi është aprovuar duke pas parasysh edhe Rekomandimin nga Komitetit për Politikë e Financa.

III


Vendimi u dërgohet: Arkivit, Zyrës për Komunitete dhe Kthim, Drejtorisë për Administratë, Kryetarit të Komunës, Ministrisë për Administrimin e Pushtetit Lokal, dhe Zyrës për Informim.



Kryesuesja e Kuvendit
Medina Braha



REPUBLIKA E KOSOVËS
KUVENDI I KOMUNËS-SHTIME
Nr.01-70/05-15347 datë: 21.05.2018



Npi – 01/121 datë: 31.05.2018

Duke u bazuar në nenin 12 si dhe nenet 17 pikat (p dhe s) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040; Si dhe bazuar në pikën 2 të Rekomandimit të Kuvendit të Komunës së Shtimes Nr.01/96, datë 30.04.2018, ku thuhet, Ekzekutivi duhet të largojë sa më parë Kiosqet që gjenden në pranë hyrjes së Shkollës Filllore “Emin Duraku” në Shtime, Kuvendi i Komunës analizo i Propozim-Vendimin e Drejtorisë për Shërbime Publike për largimin e Kiosqeve, dhe aprovoi këtë:

V E N D I M

**PËR LARGIMIN E TË GJITHA KIOSQEVE NË AFËRSI TË SHKOLLËS FILLORE
“EMIN DURAKU” NË SHTIME**

I

Kuvendi i Komunës së Shtimes në mbledhjen e pestë të rregullt për vitin 2018, të mbajtur më 31.05.2018, unanimitisht aprovoi Vendimin për t'i larguar të gjitha Kiosqet që gjenden pranë hyrjes të Shkollës Filllore “Emin Duraku” në Shtime.

II

A r s y e t i m: Kuvendi ka vendosur sipas diapozitivit të këtij vendimi mbi bazën e:

- Rekomandimit nga Komitetit për Politikë e Financa.
- Propozim-Vendimin e Drejtorisë për Shërbime Publike,
- Raport\Informat nga Policia e Kosovës, Stacioni në Shtime mbi gjendjen dhe keqpërdorimin e Kiosqeve jofunksionale nga persona të tretë,
- Procesverbalin nga Sektori i Inspektoratit, mbi keqpërdorimet dhe veprimet ilegale të Kiosqeve, shitja e duhanit personave jo madhor etj;
- Kërkesën\Informatën nga Drejtoria e Shkollës Filllore “Emin Duraku” për pengimin e procesit mësimor nga Kiosqet në fjalë,
- Propozimi i Drejtorisë për Planifikim Urban, Kadastër dhe Gjeodezi që kjo hapsirë të planifikohet për Trotuar të integruar dhe mbjellje të drunjëve dekorativ.

III


Vendimi u dërgohet: Arkivit, Drejtorisë për Shërbime Publike, Drejtorisë për Planifikim Urban, Kadastër dhe Gjeodezi, Kryetarit të Komunës, Ministrisë për Administrimin e Pushtetit Lokal, dhe Zyrës për Informim.



Kryesuesja e Kuvendit
Medina Braha



REPUBLIKA E KOSOVËS
KUVENDI I KOMUNËS-SHTIME
Nr.01-70/05-15347 datë:21.05.2018



Npi – 01/122 datë: 31.05.2018

Duke u bazuar në nenin 12 pika (d) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040; Nenit 13.1 pika (a) dhe neni 13.3 të Rregullores Komunale për ndarjen e Bursave për Studentë 01Nr.06/570-60 të datës, 30.03.2012, Kuvendi i Komunës në mbledhjen e mbajtur më: 31.05.2018, aprovoi këtë:

V E N D I M

**PËR ZGJEDHJEN E KOMISIONIT PËR NDARJEN
E BURSIVE PËR STUDENTË**

I

Kuvendi i Komunës së Shtimes, në mbledhjen e pestë të rregullt për vitin 2018, të mbajtur më: 31.05.2018, me shumicën e votave aprovoi Vendimin për zgjedhjen e 2 (dy) anëtarëve të Komisionit për ndarjen e Bursave për Studentë, nga gjithsejtë 5 (pesë) anëtarë sa është paraparë me rregullore, si vijon:

II

Dy anëtarë të Komisionit nga Kuvendi sipas nenit 13.1 pika (a) e Rregullores Komunale për ndarjen e bursave për Student, Nr.01/06/570-60 dt. 30.03.2012, unanimisht u zgjedhën:

1. Znj.Fatmire Ferati (Përfaqësuese e pozitës)
2. Z.Besnik Seferi.....(Përfaqësues i opozitës)

III

Dy anëtarë të Komisionit nga Ekzekutivi, sipas nenit 13.1 pika (b) e Rregullores Komunale për ndarjen e bursave për Student, me numër 01Nr.06/570-60 dt. 30.03.2012, i ka emëruar Kryetari i Komunës, me vendimin Nr.02/297 të datës 31.05.2018 si vijon:

3. Znj.Feride Rexhaj(Zyrtare financiare në Arsim)
4. Znj.Ardiana Rama-Gashi (Përgjegjëse për Urbanizëm)

IV

Një anëtar të Komisionit nga OJQ-të, sipas nenit 13.1 pika (c) e Rregullores Komunale për ndarjen e bursave për Student, 01Nr.06/570-60 dt. 30.03.2012, e dërgojnë përfaqësuesit e Studentëve ose shoqërisë civile, si vijon:

5. Z.Arben Topalli(OJQ “Vizionida” - Shtime)

V

Vendimi u dërgohet: Arkivit, Anëtarëve të komisionit, Drejtorisë për Arsim, Kryetarit të Komunës, Ministrisë për Administrimin e Pushtetit Lokal dhe Zyrës për Informim.



Kryesuesja e Kuvendit
Medina Brahaj



REPUBLIKA E KOSOVËS
KUVENDI I KOMUNËS-SHTIME
Nr.01-70/05-15347 datë: 21.05.2018



Npi – 01/123 datë: 31.05.2018

Kuvendi i Komunës së Shtimes, shqyrtoi kërkesën e z.Kemajl Ademaj, Rr.”Sali Çeku” p.n. Ferizaj, Avokat i autorizuar nga firma “Newco IMK Shtime Warehouse” L.L.C NRB:70335028. Kërkesa Nr.01-70/05-14631/18 datë: 14.05.2018, dhe mori këtë:

KONKLUZION

**PËR SHTYRJEN E SHQYRTIMIT TË KËRKESËS Nr.01-70/05-14631/18 TË
AVOKATIT KEMAJL ADEMAJ - FERIZAJ**

I

Kuvendi i Komunës së Shtimes në mbledhjen e pestë të rregullt për vitin 2018, të mbajtur më 31.05.2018, me shumicën e votave vendosi që ta shtyj për shqyrtim deri në mbledhjen e radhës, Kërkesën Nr.01-70/05-14631/18 datë: 14.05.2018, e z.Kemajl Ademaj, Rr.”Sali Çeku” p.n. Ferizaj, Avokat i autorizuar nga firma “Newco IMK Shtime Warehouse” L.L.C NRB:70335028, i cili ka kërkuar nga Kuvendi i Komunës së Shtimes, Kompensim të pasurisë së paluajtshme me sipërfaqe rreth 9000m².

II

A r s y e t i m: Kuvendi ka vendosur sipas diapozitivit të konkluzionit me arsyetimin që Drejtoria për Planifikim Urban, Kadastër dhe Gjeodezi të grumbullojë më shumë Informata lidhur me kërkesën, përkatësisht me historikun e ngastrës kadastrale: P-72809093-01401-1, Zona Kadastrale-Shtime; Te vendi i quajtur “Gështenja”; Evidentuar në emër të “Newco IMK Shtime Warehouse” L.L.C. pronar i paluajtshmërisë-qirambajtje për 99 vite.

III

Vendimi u dërgohet: Arkivit, Palës, Drejtorisë, Kryetarit të Komunës, Zyrës për Informim.



Kryesuesja e Kuvendit
Medina Brahaaj



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVO
KUVENDI KOMUNAL / SKUPŠTINA OPŠTINE / MUNICIPAL ASSEMBLY
SHTIME / ŠTIMLJE



REPUBLIKA E KOSOVËS-REPUBLIKA KOSOVO KOMUNA E SHTIMES/OPŠTINA ŠTIMLJE	
Nr. i Prot./Br. Prot.	<u>01/124</u>
Nr. i Faqeve/Br. strana	<u>5</u>
Data/Dana/	<u>05.06.2018</u>
SHTIME/ŠTIMLJE	

Data/Datum/Date:	05.06.2018
Nr./Br./No	Npi – 01/124
Për/Za/To:	Ministria për Administrimin e Pushtetit Lokal - Prishtinë - Departamenti Ligjor
Përmes/Preko/Through:	Sekretaria e Kuvendit – Zyrtari, z. Idajet Rexhepi
Nga/Od/From:	Kryesuesja e Kuvendit të Komunës znj. Medina Brahaj
Lënda/Predmet/Subject :	FLETËPËRCJELLËSE

Bashkangjitur kësaj shkrese, u dërgojmë Vendimet e aprovuara në mbledhjen e pestë të rregullt për vitin 2018 të Kuvendit të Komunës së Shtimes, e mbajtur më 31.05.2018, si vijon:
(Vendimet në gjuhën Shqipe)

Tabela e vendimeve :

Nr	Emërtimi i Akteve nënligjore të aprovuara në Kuvendin e Komunës së Shtimes më 31.05.2018	Numri i Protokolit
1	VENDIM - për nxjerrjen në diskutim publik KAB-it 2019-2021	01/118
2	VENDIM - për diskutim publik të Planit të punës të KKSB-së 2018-2019	01/119
3	VENDIM - për diskutim publik të Planit të veprimit për komu. Rom-Ashkali 2018-2021	01/120
4	VENDIM - për largimin e Kiosqeve të Shkollës 'Emin Duraku' - Shtime	01/121
5	VENDIM - për zgjedhjen e Komisionit për ndarjen e Bursave për Student	01/122



Zyrtari i Kuvendit
Idajet Rexhepi